REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE,PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE

SEKTORI JURIDIK DHE I PROKURIMEVE

PROJEKT-VENDIM

Nr.56, Date 24 02 2026

"PËR MIRATIMIN E BASHKËORTAKËRISË NËPËRMJET DHURIMIT TË NJË PJESE TË KUOTËS NGA SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ALBEDO SOLAR SHPK DHE AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES PËR DHURIMIN E KUOTAVE"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8417,datë 22.11.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 113 pika 1 shkronja b), Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenit 68,70,71,-104 të Ligjit Nr. 901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"i ndryshuar, nenit 8,9,54 pika 1 germa d) të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligji 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar , VKB Nr. 49 Datë 30.04.2026 "Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për të negociuar me shoqëritë të cilët kanë shprehur interes për ta bërë Bashkinë bashkëortake në shoqëritë e tyre".

PROPOZOJ:

1. Të miratojë bashkëortakërinë mes Bashkisë Devoll dhe Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Albedo Solar" shpk nëpërmjet dhurimit të 26% të kuotës sipas kushteve, te drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në Draft-Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Dhurim Kuotash ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë "Albedo Solar" shpk (bashkëngjitur projekt vendimit), me qëllim realizimin e projektit për ndërtimin dhe zhvillimin e një parku fotovoltaik me fuqi të instaluar deri në 60 MW.
2. Bashkia Devoll pas nënshkrimit të marrëveshjes për transferimin e kuotave do të bëhët zotëruese e 26 % të kapitalit të shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton ligji dhe statuti i shoqërisë.
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Devoll për nënshkrimin e Marrëveshjes për Transferim Kuotash me shoqërinë " Albedo Solar" shpk, si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve administrative, noteriale dhe ligjore të nevojshme për zbatimin e saj.

4. Të miratojë autorizimin e Kryetarit të Bashkisë ose të personit/ave të autorizuar prej tij që të përfaqësojë Bashkinë në Asamblenë e Përgjithshme.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Devoll për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Konceptoi dhe konfirmoi bazen ligjore:
Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe i Prokurimeve
Eriksela Avdo

Konfirmoi:
Sekretari i Përgjithshëm
Adriana Rushitaj

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE,PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE
SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE

Nr.2449 Prot **Bilisht me, 14/04/2026**

RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

"PËR MIRATIMIN E BASHKËORTAKËRISË NËPËRMJET DHURIMIT TË NJË PJESE TË KUOTËS NGA SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ALBEDO SOLAR SHPK DHE AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES PËR DHURIMIN E KUOTAVE"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Devoll!

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8417 datë 22.11.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 113 pika 1 shkronja b), Ligjin Nr.7850, datë 29.7.1994 " Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndyshuar, nenit 68,70,71,-104 të Ligjit Nr. 901/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare" I ndryshuar nenit 8,9,54 pika 1 germa d) Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendor" i ndryshuar. Në nenin 54 pika 1 gërma d) të Ligjit "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Ky relacion hartohet me qëllim propozimin për tu bërë bashkëpronare në një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emrin " ALBEDO SOLAR" shpk e cila pas nënshkrimit të të marrëveshjes për transferimin e kuotave, Bashkia do të jetë zotëruese e kuotës në vlerën 26% të kapitalit të shoqërisë.

Bashkia Devoll ushtron funksionet dhe kompetencat e saj në zbatim të Kushtetutës së Republikë së Shqipërisë, ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre dhe ligjet e tjera të posacme në fuqi. Ajo ka përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të saj.

Deri në këto momente Bashkia Devoll gjeneron të ardhura kryesisht nga taksat dhe tarifat vendore nga familjarët dhe nga bizneset e saj dhe të ardhura nga qiratë e tokave të cilat vit pas viti mbeten pothuajse në shifra dhe vlera të njëjta.

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +355811238l5-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

Kjo formë organizimi me sipërrmarjet private përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit dhe krijimit të të ardhurave nëpërmjet instrumentave ekonomike, profesionale, eficentë dhe me objektiv të qartë për gjenerimin e të ardhurave,në përputhje me legjislacionimn në fuqi dhe interesin publik të Bashkisë Devoll.

Kokretisht Shoqëria "ALBEDO SOLAR SHPK" shpk me Nipt M52027505T dhe adrese Durrës,Rruga Neki Libohova, Pasuria nr. 5/1379, vol.90, faqe 30, Zona Kadastrale 8513 është krijuar si shoqëri për të ushtruar veprimtarinë e mëposhtmë: *"Hartimi, zbatimi dhe administrimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike fotovoltaike dhe gjithe llojeve te tjera te prodhimit te energjise dhe veprave ndihmese ne gjithe territorin e Republikes te Shqiperise. Import i makinerive, pajisjeve dhe materialeve te para te nevojshme per prodhimin e energjise te gjitha llojeve dhe venia ne perdorim e tyre, etj."*

Bashkia Devoll pranon dhurimin e kuotave nga ortakët Z.Roland Milaqi i cili zotëron 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë dhe i dhuron Bashkisë Devoll 13% nga pjesa e tij dhe nga ortaku Z.Besnik Nura i cili zotëron 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë dhe i dhuron Bashkisë Devoll 13% me kushtin e vetëm që shoqëria nuk do të ushtrojë asnjë aktivitet tjeter përvec objektit të përcaktuar në ekstrakt.

Menyra e dhurimit të 26% të kuotave nga ortakët e shoqërisë "Albedo Solar" në drejtim të Bashkisë Devoll janë të përcaktuara në "Draft -Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Dhurim Kuotash" e cila ka si qëllim "ndërtimin e një parku fotovolatik me fuqi të instaluar deri në 60 ME.

Në asnjë rast objekti i veprimtarisë së shoqërisë "Albedo Solar" shpk për të cilën Bashkia Devoll po bëhet zotëruese e kuotës prej 26 % të kapitalit të shoqërisë, nuk mund të ndryshohet pa marrë më parë miratimin e Këshillit Bashkiak.

Shoqëria mund tu shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividentit aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim dhe do të shoqërohet me certifikatën e aftësisë paguese për secilin ortak.

Bashkia Devoll pas zotërimit të kuotës 26% të kapitalit të shoqërisë "Albedo solar" shpk ka të drejtën e votës në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme në përpjestim me vlerën nominale të kuotës.

Qëllimi i realizimit të kësaj marrëveshje është bashkëpunimi midis shoqërise "ALBEDO SOLAR" Shpk dhe Bashkisë Devoll për ndërtimin e nje parku fotovoltaik me fuqi te instaluar deri ne 60 MË.
Referuar Panit të Biznesit dhe Planit Financiar për Parkun Fotovoltaik "ALBEDO SUNPOËER" i cili është përgatitur nga "Instituti Dekliada -Alb" shpk , projekti i propozuar ka si objektiv kryesor realizimin e prodhimit të energjisë elektrike , sipas standardeve bashkëkohore për tregun vendas dhe eksport.

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

Qëllimi i projektit është që shoqëria Albedo solar" shpk të ndërtojë dhe të operojë brenda një parku fotovoltaik me fuqi 60 MËDC. Investimi parashikohet të realizohet për një periudhë 24 mujore dhe me një kapital fillestar në masën 31,965,930 euro me TVSH nga të cilat dhe me kredi bankare 80% duke parë efektivitetin e këtij investimi si dhe kërkesën për gjithnjë në rritje të energjisë elektrike.

Pas zbatimit të projektit dhe futjes në punë të parkut fotovolatik pritet që të ardhurat që do të përfitohen nga prodhimi vjetor i energjisë referuar do të jenë në vlerën e 8,500,000 euro.

Pas shlyerjes së detyrimeve, Bashkia Devoll do të përfitojë 26% të vlerës që do të mbetet pas likujdimit të detyrimeve që shoqëria do të ketë ndaj të tretëve.

Konkluzioni.

Më këtë veprimtari ekonomike Bashkia ka si qëllim:

- Ndikimin e drejtpërdrejt në rritjen e të ardhurave vendore përmes fitimit nga gjenerimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike pas implementimit të projektit.
- Funksionimi i shoqërisë dhe implementimi i projektit do të sjellë krijimin e vendeve të reja të punës për qyetetarët e Bashkisë Devoll.
- Zhvillimin ekonomik lokal dhe impakt social në komunitet.

Me 26% pjesëmarrje Bashkia Devoll ka përfitim potencialisht shumë më të madh, si dhe pozicion institucional shumë më të fortë. Nëse projekti strukturohet në mënyrë të kujdesshme, me hyrje të fazuar, atëherë modeli 26% është qartësisht më i favorshëm si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në aspektin e interesit publik vendor.

Gjithashtu marrëveshja e bashkëpunimit për dhurim kuote me anë të së cilës Bashkia Devoll bëhet pjesë e shoqërisë "Albedo solar" shpk ka si qëllim vetëm ndërtimin e një parku fotovoltaik me fuqi deri në 60 MË dhe asnjë veprimtari tjetër.Në marrëveshje përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Devoll si dhe vendimet strategjike që nuk mund të merren pa votën Pro të Bashkisë Devoll të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin e objektit të veprimtarisë, shitja ose tjetërsimi i aseteve kryesore , shpërbërja ose likujdii i shoqërisë, ndryshimet në statut, rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit dhe shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve si dhe cdo vendim i cili prek interesat e Bashkisë Devoll nga vendimarrja e Asamblesë të Përgjitshme në cdo rast do të marrë miratimin e Këshillit Bashkiak Devoll.

Miratimi i këtij projekt-vendimi konsiderohet i domosdoshëm dhe i justifikuar pasi garanton përfitim potencialisht të madh, afatgjatë deri në 25 vjet dhe pozicion institucional-ekonomik të fortë.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve
Eriksela Avdo

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

Nr._____prot. Datë ___.___.2026

SHOQËRIA "ALBEDO SOLAR" SHPK

Nr.____prot. Datë ___.___.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR DHURIM KUOTASH

"Bashkia Devoll, me Nipt K46919609D dhe me seli në Bilisht, person juridik publik, përfaqësuar nga Kryetari Z. Eduard Duro.

dhe

Shoqëria "ALBEDO SOLAR " shpk, me Nipt M52027505T, me seli në Durres Rruga "Neki Libohova", Pasuria Nr. 5/1379, Vol.90, faqe 30, Zona Kadastrale 8513, përfaqësuar nga administratori dhe ortaku Z. Roland Milaqi dhe ortaku Z. Besnik Nura.

E lidhur sot më datë ____/____/ 2026 , ndërmjet:

- Z. Roland Milaqi, zotërues i 50% të kuotave të kapitalit të **Shoqërisë "ALBEDO SOLAR " shpk**
- Z. Besnik Nura, zotërues i 50% të kuotave të kapitalit. të **Shoqërisë "ALBEDO SOLAR " shpk**

të cilët do të referohet më poshtë si "Ortakët Transferues"

dhe

Bashkia Devoll,me adresë: Lagjja Nr. 1, Rruga "24 Tetori" Nr. 9, Devoll, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, z.Eduard Duro, i cila do te referohet me poshtë dhe si "Përfituesi"

Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi për Dhurimin e Kuotave sipas kushteve dhe afateve si vijon:

Neni 1

Qëllimi

1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi ndërmjet palëve për zhvillimin, ndërtimin dhe operimin e një projekti fotovoltaik me fuqi te instaluar 60 MW dhe transferimi pa kundërshpërblim i 26% të kuotave të ALBEDO SOLAR shpk në favor të Bashkisë Devoll.

1.2 Marrëveshja synon gjithashtu garantimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Devoll në kapitalin e shoqërisë përmes transferimit pa kundërshpërblim të kuotave si dhe mbrojtjen e interest publiK dhe pasurise te Bashkise.

Neni 2

Baza Ligjore

2.1.Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi për Dhurim Kuotash bazohet në kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në:

- Kushtetuta e Shqipërisë,
- Ligji Nr. 44/2015 " Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" i përfitësuar
- Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", i ndryshuar
- Ligji Nr. 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar
- Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar
- VKB Nr. 49 Datë 30.04.2026 "Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për të negociuar me shoqëritë të cilët kanë shprehur interes për ta bërë Bashkinë bashkëortake në shoqëritë e tyre".

Neni 3

Objekti

3.1Objekti i kësaj marrëveshje përfshin:

a) Transferimin pa kundërshpërblim të 26% (njëzet e gjashtë për qind) të kuotave të shoqërisë Albedo Solar Shpk në favor të Bashkisë Devoll;
b) Bashkëpunimin për zhvillimin e projektit fotovoltaik;
c) Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve;
d) Rregullimin e përdorimit të pasurisë publikë të Bashkisë Devoll në funksion të projektit;

Neni 4

Gjendja ekzistuese

4.1 Kapitali i shoqërise zotërohet si vijon:

1. Z. Roland Milaqi, zotërues i 50% të kuotave të kapitalit të **Shoqërisë "ALBEDO" shpk**
2. Z. Besnik Nura, zotërues i 50% të kuotave të kapitalit. të **Shoqërisë "ALBEDO" shpk**

Neni 5

Transferimi i kuotave

5.1 Ortaku Z. Roland Milaqi transferon pa kundërshpërblim në favor të Bashkisë Devoll 13% të pjesëmarrjes në përqindje në shoqërinë "ALBEDO SOLAR" shpk.
5.2 Ortaku Z. Besnik Nura transferon pa kundërshpërblim në favor të Bashkisë Devoll 13% të pjesëmarrjes në përqindje në shoqërinë "ALBEDO SOLAR " shpk.

5.3Transferimi kryhet me akt noterial ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe regjistrohet prane QKB-së
5.4 Pas regjistrimit te transferimit, struktura e kapitalit te shoqerise do te jete:
a) Ortaku Z. Roland Milaqi – 37% të kapitalit të Shoqërisë "ALBEDO SOLAR " shpk
b) Ortaku Z. Besnik Nura – 37% të kapitalit të Shoqërisë "ALBEDO SOLAR " shpk
c) Ortaku Bashkia Devoll – 26% të kapitalit të shoqërisë të Shoqërisë "ALBEDO SOLAR " shpk
5.5 Kutotat e transferuara i japin Bashkisë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga pjesëmarrja në kapital, përfshirë të drejtën e votës, të drejtën e dividentit dhe të drejtën e informimit.

Neni 6

Statusi i pasurive të Bashkisë

6.1 Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshje nuk përbën transferim pronësie mbi pasuritë e Bashkisë Devoll.
6.2 Të gjitha pasuritë publike mbeten në pronësi të plotë dhe të pandyshuar të Bashkisë Devoll.
6.3 Pasuritë e luajthsme/ të paluajtshme të Bashkisë Devoll të cilat do të vihen ne **përdorim** te projektit per tu zhvilluar nga shoqeria do të jenë vetëm për qëllimin e përcaktuar në nenin 1 të kësaj marrëveshje, dhe vetëm pas marrjes së miratimit nga Këshilli Bashkiak.

Neni 7

Kohëzgjatja

7.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.
7.2 Në rast se do të kemi ndryshim në statut për kohëzgjatjen e shoqërisë, do të duhet që të shoqërohet me miratimin paraprak të Këshillit të Bashkisë Devoll, përpara se të bëhët ndryshimi në statut.

Neni 8

Te drejtat dhe detyrimet e Bashkise Devoll

8.1 Bashkia Devoll, si ortak me 26% te kapitalit, gezon te drejtat si me poshte:
a) Pjesemarrjen ne Asamblene e Pergjithshme.
b) Te drejten e votes sipas pjesemarrjes ne kapital.
c) Te drejten per te marre pjese ne fitimet e shoqerise.
d) Te drejten e informimit per veprimtarine ekonomike dhe financiare te shoqerise.
e) Te drejten per te emeruar nje perfaqesues ne organet drejtuese ose mbikqyrese sipas statutit.
f) Cdo pasuri e luajtshme dhe/ ose e paluajtshme në pronësi apo administrim të Bashkisë Devoll që do i vihet shoqërisë "ALBEDO" shpk në të cilën Bashkia Devoll do të jetë bashkëortake , për përdorim ,administrim dhe ose zhvillim , në të gjitha rastet do të miratohet paraprakisht nga Këshilli i Bashkisë Devoll.
g) Të drejtën për divident të fitimit të realizuar nga shitja e energjisë elektrike në përpjestim me përqindjen e kuotave që zotëron në shoqëri.